

BIBLIOTEKA

E

SHH-IL

MJ.56

SHTELLA

GJUROKASTER

# NJERIU I PUNËVE TË MIRA

tregime

## ANASTAS DUSHKU

### JEMINI

Jemini atëherë ishte tetëmbëdhjetë vjeç. Vinte i imët në fytyrë, si djalë qyteti dhe qe i bukur si vajzë. I ati nuk ishte keq nga gjendja. Kishte një shtatëdhjetë krerë bagëti, që në malësi atëherë ishte diçka. Kishte edhe tre djem të tjërë, burra të martuar. Kur pa se djali i vogël, Jemini, erdhi i mbarë në punët e mësimit, ai e dërgoi në qytet, në shkollën e mesme.

Atë kohë unë punoja çirak te një furrtar. Meqë Jemini ishte më i vogël në moshë, s'kisha ndonjë miqësi të veçantë me të. Po në qytet u afroam vetveti. Ai vinte gati çdo mëngjes e blinte simite, meqë edhe rruga nga konvikteti për në shkollë kalonte andej. Shumë shkollarë blinin simite te ne. Ustai im, një burrë nga Përmeti, ishte mjeshtër i vërtetë.

Ne fshatarët afrohemë shumë me njëri-tjetrin, për më tepër unë bija edhe kushëri me të nga ana e babait. Sapo kishte nisur Lëvizja dhe unë gjeja rastin e flisja larg e larg për këtë punë. Djali hapte sytë e më dëgjonte në heshtje. Nuk thoshte asgjë, vetëm dëgjonte. Më kuptonte e kjo dukej nga sytë e tij të menduar. Më vonë filloi të pyeste, të kërkonte shpjegime, jo vetëm për ato që i thosha unë, por edhe për gjëra të tjera, që shihte e dëgjonte andej-këtej.

Një ditë më solli një trakt. Unë nuk e bëra veten  
dhe as e pyeta si e qysh i kishte rënë në dorë. As ai nuk  
tha gjë për këtë.

— Shiko, Kamber, — foli duke më parë në sy, —  
këto gjëra mua më shqetësojnë. Dhe sa më tepër që  
mendohem për to, aq më tepër më duket sikur dëkush  
më ka zënë përfytje po më merr shpirtin.

— Ashtu është, — thashë unë. — Të gjithëve po na  
merret fryma. Është një hata e zezë kjo, që i ka rënë  
vendit të tërë përsipër. Mos shiko ata të tutë e ndonjë  
tjetër, që mbahet me njëfarë mënyre. Shumica vuajnë  
përfyrat e gojës. Tani heqim keq e më keq edhe  
nga të huajt, që na janë shtruar këmbëkryq në sofë...

E mbajta fjalën përbrenda, se e pashë që isha rrë-  
mbyer. Nuk duhej ta kisha ngarë llafin përfundën e  
familjes së tij, ndaj prita që ai të ndrydhej. Por jo. Ai  
nuk tha asgjë nga ato që më kishin shkuar në mendje  
mua. Dukej qartë se djali u kishte hyrë gjérave më  
thellë.

— Ashtu është, — më tha si ndenji e u mendua një  
copë herë në heshtje, — gjérat duken sheshit se janë  
thurur shtrembër...

E rëndonte si gur në zemër sjellja e drejtoret të  
shkollës, një italian, që u merrte shpirtin në mësimin  
e doktrinës fashiste e i vinte pastaj të rrinin gatitë e të  
nderonin me dorën shtrirë sa herë ngrihej e ulej flamuri  
i tyre. Fliste me urrejtje dhe tek ai unë shihja të  
valonte po ai shpirt i revoltuar i rinisë sonë, e cila kërkonte  
një rrugëdalje nga ajo gjendje e turbullt që kishte  
krijuar te ne pushtimi i huaj.

Në atë kohë, celula e Partisë më kishte caktuar të  
punoja në fshatrat e anëve tonë. Mbaja lidhje dhe i furni-  
zoja bazat dhe çetën e parë, që ishte formuar andej.  
Jemini vinte thuajse përditë tek unë. Rrinim në ndarjen  
prapa furrës, që shërbente përgatim, e flisnim gjithnjë  
përfunditë njëjtën gjë — përfundën e Luftës. E vija re se si,  
me kalimin e kohës, ai piqej më tepër, bëhej më serioz.  
Një ditë i thashë se do tani njihja me një shok të mirë,  
me të cilin do të kishte të bënte tanë e tutje. Ky ishte

sekretari i shkollës së mesme ku mësonte Jemini, një anëtar i celulës sonë, i cili qe ngarkuar të punonte me rininë shkollore. Djali u dha i tëri pas kësaj pune dhe tani vinte rrallë tek umë. Unë interesohesha gjithnjë për të nëpërmjet shokut. Jemini ishte një nga nxënësit më të hedhur në atë fazë fillestare të aktivizimit të të rindjeve shkollarë në Luftë. Atij i ishte besuar tërheqja e trakteve dhe e komunikatave nga një shok i cili banonte në krye të qytetit. Jemini shkonte çdo ditë e i merrte e me to në gjoks çante pa frikë rrugëve, që ndonjëherë ishin të bllokuar nga karabinierët dhe policia fashiste. Pastaj i shpërndante nëpër nxënësit e tjerë dhe këtë e bënte vetë, me një shkathtesi të çuditshme, herë gjatë pushimeve, herë edhe gjatë kohës së mësimit, në klasë. Shoku im e kishte qortuar njëherë sepse Jemini, gjatë orës së mësimit të doktrinës fashiste, ndante vazhdimisht trakte dorë më dorë, nën bankë. Më sa kuptohej, ndiente kënaqësi të veçantë që pikërisht në këtë kohë t'u jepte nxënësve matriale me fjalën e Partisë.

Ai qe një djalë shumë i shkathët. Njëherë kishte shkuar në dhomën e mësuesve e u kishte vënë nga një trakt të gjithëve nëpër çanta. Pastaj i kishte ngjitur nëpër muret e korridoreve. Atë ditë shkolla ishte bërë rrëmujë. Drejtori kishte lajmëruar kuesturën. U bënë kontolle në shkollë e në konvikti. U vendos për disa ditë rojë. Por shpërndarësi i trakteve nuk u zbulua dot. Ishte për t'u habitur se sa bukur shtirej ai djalë i padalë fshati, saqë drejtoria e mësuesit italianë kishin për të një konsideratë të veçantë, jo vetëm si ndër të parët në mësime, por edhe si një djalë i urtë e i bindur.

Kaluan disa muaj dhe papandehur, aty nga vjeshta e parë, Jemini, që kishte qenë për pushime verore, nuk u kthye. E kishin mbajtur në fshat. Ata të shtëpisë së tij

thanë se ai ishte sëmurë, por nuk qe ashtu. Ngjarjet e mëvonshme vërtetuan se ata ishin trembur nga rruga që kishte zënë ai dhe nuk e lanë të vazhdonte mësimet.

Aty nga pranvera unë u hodha në ilegalitet. E kisha rregulluar me një marrshall italian të intendencës e blyja prej tij armë, munizione e veshmbathje, të cilat pastaj i përcillja në çetë. Mirëpo kjo u zbulua. Marrshallin e arrestuan. Unë shpëtova për qime dhe u hodha në anët tona të qëruara.

Në atë kohë Balli Kombëtar punonte akoma nën rrogoz me italiannët dhe e hiqte veten si organizatë patriotike e antifashiste. Kjo ishte si ajo bomba me tym. Ata mundoheshin të bënин përvete fshatarët, sidomos fshatarët e mesëm, të cilët lëkundeshin sa andej-këtej, sepse shumica e të pasurve ishin lodhur me ta prej kohësh. Në fshatin tonë e vëtmja familje që rrinte mënjanë ishte ajo e Jeminit. I ati dhe tre vëllezërët e tij nuk përziheshin. Rrinin mbyllur në guaskën e tyre dhe shikonin interesin, pa dashur t'ia dinin se q'po ndodhët në botë. Edhe kur këshilli i fshatit bënte mbledhje me popullin dhe shtronë probleme, që dilnin përditë nga lufta, ata vinin të gjithë sa përsy e faqe, po rrinin si të huaj, pa u interesuar përasgjë.

Jemini dukej rrallë rrugëve të fshatit. Në kishim vendosur të bënim çmos për t'i tërhequr edhe ata në anën tonë. Më përpara mendova të flisja njëherë me djalin, Unë e njihja mirë dhe kisha besim se Jemini do të na ndihmonte. Një ditë e takova në krye të fshatit, larg shtëpisë së tij, ku nuk na shikonte njeri.

— E kanë zënë keq, — më tha duke iu përgjigjur pyetjes sime. — Vjen shpesh këtej ai, Sejfullai, një kusħeri i largët i babait, i cili punon sekretar në nënprefekturë. Ai mban lidhje me Sali beun dhe ky e dërgon këtej për punë të Ballit. Unë yetë e kam dëgjuar se si i premtoi babait njëqind kuintalë bereqet e pesëqind napolona, në qoftë se lidheshim me ta. Babai nuk kundërshtoi. Tani ata rrinë sa përsy e faqe mënjanë, por i kanë dhënë fjalën dhe janë me Ballin... Këtë ta dini mire...

— Çudi, — thashë, — edhe vëllezërít kështu mien-dojnë?

— Po. Por edhe sikur të mos duan, s'kanë si t'ia bëjnë. Ti e di, çfarë thotë plaku, bëhet në shtëpi...

Kjo ishte e vërtetë. Jo vetëm i ati, por edhe djemtë ishin njerëz të pagdhendur e fanatikë sa s'kishte ku të vente më. Djali kishte të drejtë.

— Domethënë, ti thuà se nuk i sjellim dot në rrugë të mbarë, ë? — pyeta, megjithëse isha i sigurt për përgjigjen e tij.

— Hic mos u lodhni, — m'u përgjigj pa u menduar fare. — Ata janë shitura kokë e këmbë. Mos shiko se rrinë ashtu urtë e butë. Kur të vijë koha, do të dalin hapur me Ballin. Ke për të parë. Pernatë rrinë e bëjnë hesape çfarë do të blejnë me paratë që u premtuan. Sejfullai ua ka kripur kokën e u thotë se komunistët do t'u marrin bagëtinë e plaçkat e shtëpisë. Nuk e kuptojnë se nga ato krerë bagëti, që kemi, nuk na bien secilit veçse nga dhjetë-dymbëdhjetë kokë...

— Mirëpo ti, në këtë mes, çfarë do të bësh?

Hapi syté.

→ Unë?! — tha i zënë në befasi nga kjo pyetje. — As unë nuk di ç'të them.... — Nuk e sosi fjalën dhe e pashë se sa keq e ndjeu veten atë cast, sikur të mos kishte menduar kurrë se si do ta zgjidhët këtë punë. Unë shtanga në vend nga habia, sepse isha i sigurt që ai do ta ndante fjalën menjëherë, pa u menduar fare e do të hidhej në anën tonë, ashtu siç kishte vepruar në qytet. Por ai nuk tha asgjë të qartë për vete. Nuk e besoja kurrë që ai të rrinte mënjanë e aq më tepër të bënte ashtu si thoshin i ati dhe vëllezërít e tij. Kushdo që të ishte në vendin tim, këtë besim do të kishte pasur.

— Do të vijmë sonte nga ju dhe do të flasim, — thashë.

— Si të doni. Mua më duket se s'ka për të dalë gjë. Ata janë të lidhur shumë pas gjësë dhe parasë.

Atë ditë, unë, kryetari i këshillit dhe një burrë me moshë të kaluar, anëtar i këshillit, u shkuam në shtëpi. Secili nga ne kishte njëfarë miqësie me familjen e tyre,

ndaj shkuam pikërisht ne të tre. Përpara hyri Sabriu, kryetari i këshillit të fshatit, pastaj ai shoku tjetër e më në fund, unë, si më i ri në moshë.

— Vdekje fashizmit! — përshëndeti kryetari në të hyrë dhe nderoi me grusht.

— Urdhëroni... bujrëm, — tha plaku, që rrinte në krye të vatrës, pa iu përgjigjur përshëndetjes sonë, sikur të mos kishte dëgjuar asgjë.

— A pranoni miq? — pyeti kryetari i këshillit, si për ta zbutur ftohtësinë e pritjes.

— Ç'janë këto llafe, more Sabri?! — ia bëri plaku si i prekur gjoja nga fjalët e kryetarit tonë. — Urdhëroni, uluni...

Fjalët për shëndetin, për punën, për gjënë e gjallë e për kohën u sosën. Dukej qartë se ata e merrnin me mend qëllimin e vizitës sonë, sepse rrinin si mbi gjemba. Bisedën e ngiste plaku, ndërsa të tre djetëtë e tij rrinin nursëzë e të heshtur, sikur midis nesh pritej të niste një ndeshje dhe ata po bëheshin gati që t'i bënin ballë. Kjo s'ishte shenjë e mirë, por ne kishim vendosur t'i shkonim kësaj pune gjer në fund, me gjithë pritjen e ftohtë dhe me gjithë paralajmërimin e Jeminit.

Djali i madh, një burrë trupmadh, afër të dyzetave, u ngrit nga vendi si me përtesë, solli kupat, i mbushi me raki dhe na i vuri përpara, pastaj u ul në vendin e tij pa folur. Jemini ishte strukur te cepi i dhomës. Që mbështetur te muri, me sytë nga ne, e priste çfarë do të ndodhë më tej. Tek e pashë ashtu, m'u duk një krijesë e dobët, e mjerë dhe, nuk e di as unë përsë, në ato caste më erdhi shumë keq e m'u duk sikur gjithçka do të binte e do të shkrevej mbi të. U pamë për një hop në sy. Jemini tundi lehtë kokën në shenjë mohimi. Kështu që unë kuptova edhe një herë tjetër se gjithçka ishte e kotë. Plaku ktheu kokën atë çast dhe e pa. Rrudhi vetullat.

— Ti shko e rri matanë! — e urdhëroi prerë. Pastaj bëri me kokë dhe e shoqëroi me sy gjersa Jemini tërhoqi derën e dhomës e doli.

Kryetari nuk e zgjati. I foli plakut për luftën që ki-

shin bërë gjithnjë njerëzit tanë kundër të huajve dhe pastaj e lidhi fjalën me atë, që duhej të bënte secili për shpëtimin e vendit. I thoshte fjalët shtruar e qetë, por prerë, sikur qëllonte me sëpatë, ashtu sic e kanë zakon të merren vesh midis tyre malësorët. Plaku rrinte e dégjonte kokulur, pa bërë zë. Ai vërtiste gjithë nervozizëm kokrrat e tespicheve nëpër gishta, sikur nuk i durohej dot, gjersa tjetri të soste fjalët. Pastaj foli edhe ai.

— Të drejta e të mira janë këto, që thua zotrote, — tha ai duke e theksuar fjalën e fundit si me qesëndi, — por atëherë ishin vafte të tjera. Ikën e shkuan ato tani. Greku një maliher kishte në dorë. Maliher kishim edhe ne. Apo s'është kështu? Na ra e i ramë, gjersa theu qafën matanë Gramozit e vajti në esfel... Ja kështu, Po që ta ngas llafin, tani është ndryshe, vallahi... Italia nuk të nget, nuk të thotë giysmë fjale, po të lë në punën tënde, po nuk e trazove... Nuk të them, i huaj është e nuk e ka vendin këtu... Po kur gjarpri fle, pse ta ngasim? È? Po e ngave, do të të kafshojë, apo jo?

E mbajti llafin për një hop. U duk se kishte marrë inat nga fjalët e tij, sepse kokrrat e tespicheve morën hov e filluan të shkisnin me shpejtësi nëpër duart e tij.

— S'është puna se hedh apo nuk hedh ndonjë dyfek, — vazhdoi ai me po atë ton të përbajtur. — Po çfarë do të dalë nga kjo? È? Nuk ka për të dalë asgjë e mirë, vallahi. Do të bëhem qymyr të gjithë, i madh e i vogël. Dhe po m'u shkrumbosën konakët e po m'u bënë tym ato pak bagëti që kam, ku do të kullotin pastaj kaq gojë të shtëpisë? Këtë ma shkoqit zotrote...

Kryetari nuk nxitoi t'i përgjigjej. Ndenji për disa caste menduar, tundi kokën sikur fliste me vete dhe tha:

— Qenka puna, domethënë, për shtëpinë e për katan-dinë. Për këto qenka, jo për punë të vatanit. Xhaxha, të më falësh, po këto llafe më mirë të mos i kishte thënë fare. Kështu do të qe më mirë... për nder...

Djali i madh, u kollit, lëvizi nga vendi dhe nxitoi t'i dilte krah të atit.

— Puna nuk është aty, zoti Sabri, — tha duke shkuar kryetarin nën ato vetullat e tij të trasha e të ashpra. — Mos hidh baltë kot së koti, pa ia nxjerrë fundin llafit. Kur ka qenë koha, ne s'kemi pyetur fare pér shtëpi e pér katandi. Edhe tani u vëmë zjarrin të gjithave me dorën tonë, pér pejkamber. Më kuption? Edhe kokën nuk e kursejmë. Por jo kot, ama. Është gjynah... Ke pér të parë se ne do të jemi të parët kur të vijë puna pér gisht. Ke pér të parë, — foli ai si me inat dhe vuri grushtin e tij të madh mbi qilimin e minderit, sikur kështu po u vinte vulë fjalëve të tij.

Ata e hidhnin fjalën dhe mburreshin pér luftérat e kaluara, kur plaku kishte shkuar me burrat e fshatit. kundër andartëve që ishin hedhur këtej kufirit...

Kjo bisedë e qetë dhe e shtruar, por gjithë inat të fshehur, si ata thëngijjtë nën hi, vazhdoi kështu nga pasdrekja gjer natën vonë. Ne e kthyem dhe e vërtitëm, por nuk dolëm asgjékundi. Ata mbetën në të tyren. Nuk e shtymë punën gjer në fund, me shpresë mos u mbushej koka më vonë nga vetë lufta, që atëherë kishte marrë hov gjithandej. U ngritëm të iknim. Kryetari undal në mes të dhomës e deshi të thoshte edhe diçka, kur papandehur hyri Jemini. Djali kishte përgjuar të gjithë bisedën tonë. Unë e vura re se si ishte zverdhur në ftyrë dhe si i ndritnin sytë, sikur të ishte në ethe. Ai mylli derën prapa tij, u mbështet në të, sikur deshi kështu të mos na linte të iknim nga shtëpia dhe iu drejtua të atit:

— Mos na shkëput nga fshati, baba, — tha me zë të dridhur dhe bëri me gisht nga ai, si pér ta bërë përgjegjës pér gjithçka që do të rridhte pas kësaj. — A nuk e shikon se janë ngritur të gjithë më këmbë?! — Në zërin e djalit kishte një notë kërcënimi dhe paralajmërimi në të njëjtën kohë. Edhe sot e kësaj dite, kur kuçtoj fjalët e tij, rrëqethem.

Plaku, kur dëgjoi këto fjalë të të birit, ngriu në

vend, ngaqë i erdhën papritur. E vura re se iu skuqën sytë nga tèrbimi.

— Po kjo ç'është tani?! Ç'është kjo... pizeveng! U ngriten këmbët t'i bien kokës... — Nuk ishte në vete. Tha edhe ca fjalë të tjera pa lidhje dhe, papandehur, e qëlloi me sa fuqi pati. — Shporru, qafir! — bërtiti me zë të ngjirur.

Ishte një gjë e rrallë në atë kohë të ngruhej më i vogli i shtëpisë e t'u kanosej kështu të mëdhenjve, si Jemini. Këto ishin ligje të lashta e të egra, që nuk kishte guxuar t'i shkelte pothuajse askush gjer atëherë. Vëllai i madh nuk e zgjati. E përfshiu Jeminin nga krahу, hapi derën dhe e vërviti jashtë.

S'ka gjë më fisnikë sesa të përpinqesh ta shpëtosh njeriun. Por kjo është një fjalë goje. Njerëzit i tërheq prapa vargu i paragjykimeve, i interesave të ngushta, i përmban frika dhe forca e zakonit, që u janë ngulitur në shpirt si çengela e nuk i lëshojnë.

Kryetari i këshillit nuk kishte shkollë, por ishte me një barrë mend. Ai i kuptonte dobësitë e të tjerëve dhe e ndiente veten të lënduar që nuk po e sillnin dot në rrugë të mbarë këtë familje. Ne e kuptonim fare mirë se peshën kryesore, në këtë mes, e kishte plaku. Por ai ishte bërë gur dhe nuk luante nga e tija. Jemini kishte pasur të drejtë. Sado që dërguam njerëz edhe më vonë pér t'i bindur, nuk nxorëm asgjë. Plaku ua priste fjalën me sëpatë. Duke e parë veten ngushtë, pas nja dy javësh, ai i mori tre djemtë dhe shkoi në mal, në kullotat e bagëtive, lart në Qafën e Shkozës, që ishte nja katër orë udhë në këmbë.

Atëherë ne bëmë përpjekjen e fundit. Dërguam Qazim Sejjinin, njërin nga partizanët më të vjetër të çetës, që e thirrëm në fshat pikërisht pér këtë punë. Ky ishte njeri, të cilit i peshonte fjala dhe, veç kësaj, kohët e fu-